



MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTOR I ARKIVËS-SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Nr. Prot. / Org. Unit: 013	Nr. Prot. / Prot. No: 331
Nr. i faqeve / Stranica: 2	Data: / Date: 30/03/2015
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje
Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology

Kabineti i Ministririt/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Nr. 127/10/AB
Datë: 30 mars 2015

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, nenin 8 (1.4) dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dt. 22 mars 2011), si dhe në bazë të nenit 2 dhe 6 të Udhëzimit administrativ të MASHT-it nr. 9/2008, dt. 26 maj 2008, nxjerr:

VENDIM
për themelimin e shkollës

1. Themelohet Shkolla Fillore e Mesme e Ulët "Model".
2. Selia e shkollës është në lagjen "Arbëria" në Komunën e Prishtinës.
3. Mësimi në këtë shkollë do të zhvillohet në gjuhën shqipe.
4. DKA në Prishtinë duhet të zhvilloj të gjitha procedurat e nevojshme për fillimin e mësimin në këtë shkollë.
5. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Ministri.


Arsyetim

Duke u mbështetur në dispozitat e lartshënuara si dhe në bazë të kërkesës së Drejtorisë Komunale të Arsimit nr. 03.031.57986 të datës 09 mars 2015 dhe procesverbalit të Komisionit për themelim të institucioneve arsimore, të datës 23 mars 2015, i cili shqyrtoi elaboratin dhe dokumentacionin përkatës, realizoj verifikimin e kushteve të objektit, infrastrukturën e brendshme dhe të jashtme të objektit shkollor dhe konstatoj se janë plotësuar kushtet për themelimin e Shkollës së Mesme të Ulët, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr. 9/2008, të dt. 26 maj 2008, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi ju dërgohet:

1. Komisionit për themelim të institucioneve arsimore;
2. Drejtorisë Komunale për Arsim në Prishtinë;
3. Kabinetit të Ministrit;
4. Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
5. Departamentit për Politikat e Arsimit Parauniversitar të MASHT;
6. Departamentit Ligjor;
7. Arkivit të MASHT.

Prof. dr. Arsim BAJRAMI, *ministër*



REPUBLICA E KOSOVES
MINISTRI E ARSIMIT, SHKENCES DHE
TEKNOLOGJISE
Prof. dr. Arsim BAJRAMI